



Tatimet

Tatimet në Zvicër janë të varura nga vendbanimi. Tatimet më të rëndësishme për personat privat janë të ardhurat, pasuria dhe tatimi në vlerën e shtuar.

Sistemi tatimor

Në Zvicër marrin tatim, shteti, kantonet, komunat dhe kishat e vendit. Njeriu e dallon tatimin direkt dhe indirekt. Tatimet më të rëndësishme direkte janë nga të ardhurat dhe tatimi për pasuri, këto duhet direkt nga personi që ka detyrim tatimor t`i paguaj. Tatimet indirekte ndër të tjera janë, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi për duhan apo tatimi për lëndë djegëse si naftë etj. Këto tatime janë në çmimin e mallërave të dhëna. Meqë për shumë tatime kantonet dhe komunat kanë përgjegjësinë, ekzistojnë në tatimin e direkt në mes vendbanimeve dallime të mëdha. Bashkëshortët tatimohen s`bashku.

Tatimi burimor

Të ardhurëve të ri prej jashtëvendit ju ndalet tatimi burimor direkt prej rrogës (Quellensteuer| Impôt à la source). Lajmërimin e bënë për punëmarrësit, punëdhënësi. Tatimi është i varuar nga të ardhurat, prej gjendjes familjare (i pa martuar, i martuar, i ndarë) dhe numrit të fëmijëve. Ndryshimet duhet njeriu menjëherë t`i lajmëroj. Prej tatimit burimor ka ndalesa të ndryshme shtesë të mundshme, p.sh. për depozitim në shtyllën 3., cinsi për borgje, shpenzimet për sëmundje etj..

Kush ka pasuri në Zvicër, duhet me paraqitë dhe për këtë të paguaj tatim veçmas. Nga të ardhurat prej 120`000 frangave në vit duhet të bëhet sqarimi për tatim (tatim vjetor i rregullt).

Kush është i martuar me një bashkëshorte apo një bashkëshort me një pasaportë zvicerane apo me leje qëndrim C, duhet po ashtu t`i plotësoj formularët dhe të paraqesë tatimin (tatim vjetor i rregullt).

Administrata kantonale për tatim (Kantonale Steuerverwaltung | Intendance des impôts cantonale), jep informacione të tjera për tatimin burimor.



Tatimet e rregullta

Personat me pasaportë zvicerane apo me lejeqëndrim C tatimohen mbi të ardhurat vjetore (ordentliche Besteuerung | Fiscalité ordinaire). Atyre nuk ju ndalet tatimi prej rrogës. Ata duhet t`i plotësojnë fletët deklaruese për paraqitje të tatimit (Steuererklärung | Déclaration d`impôts) dhe tatimin ta paguajnë me faturë. Plotësimi i fletëve deklaruese për tatim, dhe për zviceranet dhe zviceranët është kompleks. Është e këshillueshme që për herën e parë të kërkohet ndihmë. Kush nuk jep të dhëna të sakta dhe nuk e deklaron pasurinë e bënë veten të dënueshëm. Të dhënat për tatim mund të plotësohen në internet. Te pytjet e përgjithëshme për tatim të rregullt vjetor, është komuna e banimt një mundësi e mirë për pyetje. Për tatim të rregullt vjetor është komuna përgjegjëse .

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/parat-dhe-tatimi/tatimet